



2060/3
29.10.2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS

Nr. 266 prot.

Elbasan, më 29.10.2020

VENDIM

Nr. 30 Dt. 29.10.2020

Për mënyrën e zhvillimit të mësimi në programet e studimit të
Fakultetit të Shkencave të Natyrës

Në mbledhjen e Dekanatit të datës 26.10.2020 u vendos që mësimi në Fakultetin e Shkencave të Natyrës të zhvillohet i kombinuar në auditore dhe online sipas përcaktimit të mëposhtëm :

- Për programin e studimit Bachelor në Biologji - Kimi mësimi do të zhvillohet në auditore për të tre vitet.
- Për programin e studimit Bachelor në Matematikë – Fizikë mësimi do të zhvillohet në auditore për të tre vitet.
- Për programin e studimit Bachelor në Matematikë -Informatikë mësimi do të zhvillohet në auditore për të tre vitet.
- Për programin e studimit Bachelor në Teknologjitë e Informacionit mësimi do të zhvillohet në auditor për vitin e parë, ndërsa për vitin e dytë dhe të tretë leksionet do të zhvillohen online, ndërsa seminarët dhe laboratorët do të zhvillohen në auditore.
- Për programin e studimit me karakter profesional në Teknologji Laboratori, Teknik Mjedisi, Logjistikë dhe Mekatronikë mësimi do të zhvillohet në auditore për vitin e parë, ndërsa për vitin e dytë leksionet do të zhvillohen online, ndërsa seminarët dhe laboratorët do të zhvillohen në auditore.
- Për programin e studimit Master Profesional në Teknologjitë e Informacionit mësimi do të zhvillohet në auditor për vitin e parë, ndërsa për vitin e dytë leksionet do të zhvillohen online, ndërsa seminarët dhe laboratorët do të zhvillohen në auditore.
- Për programin e studimit Master i Shkencave në Mbrojtje Mjedisi mësimi do të zhvillohet në auditore për të dy vitet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

DEKANI

Prof. Dr. Sotir MALI

